

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC/Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Ilir Rashkaj, me procesmbajtësin Shani Canziba, sekretar juridik i kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. K. nga fshati S., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2390/2014 të datës 04.03.2015, në shqyrtimin fillestar të mbajtur, me datën 08.08.2018, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Bajram Kryeziu, si dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, këtë:

## A K T G J Y K I M

### I akuzuari,

**F. K.**, nga i ati M. dhe e ëma Xh., e lindur B., i lindur me dt...., në fshatin S., Komuna e Rahovecit, ku edhe tani jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i papunësuar, i martuar, i ati i katër (4) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

## ËSHTË FAJTOR

Sepse, me datë 22.09.2014, i akuzuari në shtëpinë e tij, në fshatin S., Komuna e Rahovecit, në njehsorin elektrik me numër 15818841, ka bërë debitimin e bllobës dhe rikyçjen në rrjetin elektrik, pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, e cila gjendje faktike është konstatuar nga personat e autorizuar të KEDS-it, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me energji Elektrike – Distriktit në Gjakovë.

*Me këtë ka kryer veprën penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 41, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73 dhe 74 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, të njëjtë i shqipton:

## DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarin e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej njëqind (100) Euro dhe dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqindenjëzet (120) ditëve, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale - paushallin gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

E dëmtuara KEDS – Distrikti në Gjakovë, udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.2390/2014 të datës 04.03.2015, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin F. K. nga fshati S., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, dhe ka propozuar që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të provave i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, me datë 08.08.2018. Në këtë shqyrtim kanë qenë të pranishëm: Prokurori i Shtetit Bajram Kryeziu dhe i akuzuari F. K..

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të pranojë ose të mos e pranojë fajësinë, por paraprakisht ia ka tërhequr vërejtjen lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që i ngarkohet.

I akuzuari F. K., ka deklaruar se: E pranon fajësinë për veprën penale dhe është përdorur për rastin që ka ndodhur, por këtë e ka bërë pasi që në atë kohë punëtorët e KEDS-it ia kanë këputur rrymën për shkak të borxhit të pa paguar dhe ai është e vërtetë se e ka lidhur rrymën, por këtë e ka bërë pasi që ka qenë dhe është i gjendjes së varfër ekonomike dhe nuk ka pasur mundësi të paguajë rrymën. Tani është duke e paguar borxhin së bashku me faturat e rregullta. Edhe njëherë ka theksuar se e ndjen vetën fajtor, është përdorur për veprën të cilën e ka kryer, si dhe ka premtuar para gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të këtilla apo të ngjajshme. Andaj e ka lutur gjykatën që me rastin e caktimit të dënimit të ketë parasysh të gjitha këto rrethana e sidomos gjendjen e varfër ekonomike, pasi që është i pa punë dhe të ardhurat e vetme i siguron nga puna fizike e herëpashershme, dhe me vështirësi arrin që të sigurojë ekzistencën e tij dhe të familjes, si dhe të i shqiptojë një dënim sa më të butë.

Gjykata, gjithashtu e ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit, sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit Bajram Kryeziu, ka deklaruar se: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që i njëjti është i bazuar në provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës. I ka propozuar gjykatës që me rastin e caktimit të dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të pandehurin ta shpallë fajtor, dënon sipas ligjit, si dhe ta obligon në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, e meqenëse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe nuk është lëshuar në procedurën e provave e as në fjalën përfundimtare por e ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktakuzës.

Gjykata ka gjetur se i akuzuari ka kryer veprën penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, dhe gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte e përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Procesverbali me numër 1660361, i datës 22.09.2014, i KEDS – Distriktit në Gjakovë;
- transakcionet e konsumatorit, me numër 80004996, e datës 22.09.2014;
- foto-dokumentacioni, si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë.

Prandaj, në bazë të këtyre provave dhe vet pranimi të fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 73 dhe 74 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të të akuzuarit, se është hera e parë që kishte rënë ndesh me ligjin, se i njëjti në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë, pendimin e tij, kërkim faljen, i gjendjes së varfër ekonomike, i pa punë, të ardhurat e vetme i siguron nga puna fizike e herëpashershme, është mbajtës i familjes, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë veprë penale, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke i pasur parasysh të lartcekurat, si dhe rrethanat në të cilat i akuzuari e ka kryer veprën penale, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi me kusht, është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe është e bindur se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 41 par.1 dhe 2 të KPRK-së, dhe i njëjti është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari, si dhe konsiston në parandalimin e kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 të KPP-së.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil, sipas nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC**  
**- Divizioni Penal -**  
**P.nr.47/2016, me datën 08.08.2018**

**Sekr. juridik,**  
Shani Canziba

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Irir Rashkaj

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.